

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT

Nr. 882/5 prot.

Tiranë, më, __05.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM TE KONTRATES ME OBJEKT PROKURIMI
“SHERBIME AGROTEKNIKE(FITOPATOLOGJIKE DHE ENTOMOLOGJIKE)”
PËR NEVOJAT E DPPGJ PER VITIN 2023**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sherbime Agroteknike (fitopatologjike dhe entomologjike)” për nevojat e DPPGJ per vitin 2023.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

FPP); sherbime dezinfektimi dhe asgjesimi ne zonat urbane
sherbime dezinfektimi dhe asgjesimi
sherbime dezinfektimi nga parazitet

VLERA E FONDIT LIMIT: 9 990 000 (nentemilion e nenteqind e nentedhjetemije) lekë (pa TVSH), me burim financimi buxhetin afati mesëm 3 vjecar 2023-2025.

I mbajtur sot më date: **17 .05.2023**, në DPPGJ – Tiranë, në prani të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit të ngritur me Urdhër të Titullarit të AK, për miratimin e dokumentave të tenderit « Tender i hapur» , Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, lloji i kontratës shërbim **me afat ekzekutimi 3 muaj nga data e lidhjes se kontrates** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim nga specialistet e fushes për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

SHERBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Tabela e Grafikut te Shërbimeve dhe Ekzekutimit bashkëlidhur procesverbalit

Afatet e ekzekutimit:

Afati i kryerjes së shërbimit: 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Per objektin ne reference.

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi, është mbështetur tek grupi i punës i ngritur me urdhër **Nr. 882** Prot datën **15.05.2023** për hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve të vecanta teknike, të procedurës ne reference.

Data e hapjes së ofertave planifikuar date: 29.05.2023 Ora: 11:00

- www.app.gov.al
- *Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip.*
- *Dokumentat pa pagesë.*

Njësia e prokurimit, bazuar në parashikimet ligjore dhe në objektin e prokurimit, vendosi kriteret e kualifikimit, të cilat gjejnë pasqyrim në Shtojcën 8 të DST –ve, kriteret, të cilat u konsideruan si të nevojshme për përmbushjen e kontratës, në përpjestim me përmasat dhe veçoritë e objektit që prokurohet dhe konkretisht, si më poshtë vijon:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit, janë të pa ndryshueshme nga ato të miratuar nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE HARTUARA NGA GRUPI I PUNES SI VIJON:

Semundjet kryesore qe verehen ne druret dhe shkurret ne hapesirat e gjelbera jane:

1. Sëmundje e Hirit, vihet re tek druret e llojeve Rrap, Geshtenje, Panje, tek shkurret e llojeve, Langerstroemia, tek Trendafilat etj..
2. Kalbëzimi, vihet re rendom sidomos tek Kumbullat e Kuqe,
3. Brezhda e Vogel dhe
4. Brazhda e Madhe

Dëmtuesit kryesore qe verehen ne druret dhe shkurret ne hapesirat e gjelbera jane:

1. Karkaleci, i cili prek dhe demton pothuaj gjithë druret dhe shkurret
2. Krimbi i Gjelber
3. Morri Jeshil dhe
4. Morri i Zi

Shumë preparate janë krijuar për të mbrojtur pemët dhe shkurret, efektiviteti i të cilave është konfirmuar tashme nga përdoruesit e mirembajtjes së gjelberimit.

➤ **Ndër insekticidet që tregojnë rezultatet më të larta dhe mund të perdoret sipas listes se pmb-ve të regjistruara për t'u importuar dhe tregtuar në Republikën e Shqipërisë janë:**

Pirimiphos methyl 50EC Insekticid, me spektër të gjerë përdorimi. vepron në mënyrë të shpejtë nëpërmjet kontaktit dhe avujve.

Lënda vepruese: Pirimiphos methyl

PËRMBAJTJA: Pirimiphos methyl: 50%

Lëndë ndihmëse: 50%

Numri i regjistrimit: AL: 5/2-14.11.2008

KS: 100-0771-11-2007/10.03.2007

Formulimi: Koncentrat i emulsionueshëm

Fusha e përdorimit përfshin pemët dhe bimët zbukuruese dhe kunder insekteve si; Morrat, Vemjet, Tripsat, Tartabiqet, Këpushat Krahëbardhat, Çimkat, Breshkëzat, Pleshtat, etj.. Përdoret 0,1 - 0,2 litra Pirimiphos methyl 50 EC për dynym. Kur bëhen trajtime tokësore përdoren 50 - 70 litra ujë për dynym. Në rastin e spërkatjeve ajrore përdoren 0.2 – 0.3 litra ujë për dynym. Gjatë trajtimit të sigurohet një lagje e mirë e masës vegjetative.

Abamektin 1.8 %deri 1 liter per hektar. Abamektina 1.8.% është një akaricid- insekticid që ka një spektër të madh veprimi. Shkatërron akaricidet dhe ka mundesi për ta përdorur atë në zona të mëdha. Eliminimi i dëmtuesve pas përpunimit ndodh brenda 6 orëve, efekti zgjat të paktën 2 javë. Numri i trajtimeve është 1 ose 2 here.

Sperkatje me insekticide per mbrojtjen ndaj insekteve te ndryshme si: Morrat, Vemjet, Tripsat, Tartabiqet, Këpushat Krahëbardhat, Çimkat, Breshkëzat, Pleshtat ne objektet si me poshte vijon

MASAT PARAMBROJTËSE -Evitoni kontaktin me gojën, sytë dhe lëkurën. - Evitoni thithjen e tretësirës spërkatëse me anë të frymëmarrjes. -Mos hani dhe mos pini lëngje e duhan gjatë spërkatjes. -Para fillimit të spërkatjes vishni pajisje mbrojtëse. -Lani duart dhe pjesët e pambuluara të trupit para se të hani ose të pini, si dhe pas përfundimit të spërkatjes. -Lani pajisjetmbrojtëse para përdorimit tjetër. -Ruajeni vetëm në ambalazhin fillestar, në vende të sigurma, largfëmijëve, pijeve dhe ushqimeve për njerëzit dhe kafshët.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN: -Në rast kontakti me preparatin lahuni me ujë të bollshëm dhe sapun. -Në rast se gjatë spërkatjes nuk ndjeheni miredhe në rast gëlltitje mos shkaktoni të vjella, çojeni të aksidentuarin tek mjeku dhe i tregoni atijetiketën. Antidot: Atropina, PAM, TOXOGONIN.

Këtu kemi dozën për 1 spërkatje. Eshtë e nevojshme që të bëhen minimumi deri në 6 trajtime.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (2% te vleres se fondit limit)*
- c. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- d. *Formulari sherbimeve dhe grafikut ekzekutimit sipas shtojces 6;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 41 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2 KAPACITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore (2020,2021,2022) nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë **jo më e vogël se 39%** të vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe vërtetimin.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022)**, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, mbi bazën e të cilave, AK mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilanci të tyre vjetore, për një periudhë maksimimi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore të ardhurave: “Çdo tatimpagues për gatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilanci kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”; si dhe pikës c) të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, ku parashikohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: ... c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilanci, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”. Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

Kritere të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik, janë argumentuar nga grupi i punës, specialistet e fushës nisur nga natyra dhe permasat e kontrates, specifikimet teknike, grafiku i shërbimit dhe ekzekutimit, fushës së veprimtarisë së institucionit, sipas procesverbalit nga specialiste të fushës të cilat janë ngritur me urdher nga Titullari i AK Nr. 882 prot, date 15.05.2023 konkretisht si vijon:

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të vogël se 19% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**. .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se 19% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar ne piken 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”**

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë **II.5.A** për tregtim te produkteve te mbrojtjes së bimëve.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë **II.8.B** për “Shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i licensuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nen ligjore

Bazuar ne piken 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme **2.3.2** dhe **2.3.3** janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; bazuar gjithashtu VKM 538 date 26.05.2009 ”Per Licensat dhe Lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licensimit (QKL), VKM 1188 dt: 20.08.2008 ”Për miratimin e rregullave për importin,

tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar”, si dhe Ligjit 9362 dt.24.03.2005 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve" si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, për të përmbushur këto kriter duhet të paraqesi konkretisht:

a) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **ISO 45001-2018**.

Argumentimi: Vendosja e kriterit lidhur me certifikimet ISO bazohet në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se, Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente, konkretisht:

Vendosja e këtyre kriterëve është e bazuar në faktin që certifikata ISO garanton që operatorët ekonomik zbatojnë në punën e tyre procedurën të certifikuar ndërkombëtare për të garantuar shërbime me kualitet.

ISO 45001:2018

Çdo kompani ka detyrimin të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit.

ISO 45001 është standardi ndërkombëtar i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Kërkesat e standardit ISO 45001 përfshijnë: vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës,

zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Certifikimi ISO 45001 mund të merret nga çdo kompani, pavarësisht aktivitetit të saj si dhe risqeve të shëndetit dhe sigurisë.

Ky certifikim konfirmon angazhimin e shoqërisë për të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur punonjësit e saj dhe të çdo personi tjetër në ambientet e saj.

Bazuar në piken 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, autoriteti/enti kontraktor i **kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin**”

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e këtij shërbimi objekt kontrate duhet të disponojë të paktën **15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të punësuar**, ku të paktën **5 (pesë)** të jenë të trajnuar për shërbime dezinfektimi dhe të paktën **5 (pesë)** të jenë të trajnuar për shërbime gjelbërimi (certifikata trajnimesh perkatese) **për 3 muajt e fundit të vërtetuar me:**

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listë - pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Duke marrë shkas nga përcaktimi i llojit të shërbimeve vihet re se janë një sërë zërash të cilat kërkojnë një kapacitet punëtorësh të përpjestueshëm me numrin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor bazuar në volumnin, ditët e punës, dhe kohëzgjatjes së shërbimit. Fakti i kërkesës së numrit të të punësuarve për 3 muajt

e fundit i jep siguri dhe qëndrueshmëri dhe si pasoje dhe besueshmëri operatorit ekonomik.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si natyra e shërbimit objekt kontrate që kërkohet. Pasja e një stafi të tillë tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë me sukses kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

*Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën **15 punonjësish** është në përputhje me llojin e shërbimit të kërkuar.*

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar në piken 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, autoriteti/enti kontraktor i **kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari** dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera

shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”

- 2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **te punësuar nje staf teknik mbështetës te kualifikuar** të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht punonjës sipas profileve të mëposhtme:
- 1 (një) inxhinier pyjesh
 - 1 (nje) inxhinier mjedisi/agromjedisi/menaxhim mjedisi i cili te jet ei pajisur me certifikate trajnimi per menaxhim e mjedisit.
 - 1 (nje) agronom, i pajisur me license ne zbatim per punime ne siperfaqet e gjelberta, parqe.
 - 3 (tre) shoferë, te pajisur me Dëshmi Aftësie Profesionale ku të paktën 1 shofer me Dëshmi Aftësie Profesionale automakinist.
 - 10 (dhjetë) punonëtorë

Për të vertetuar se operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik me profilet e punës të cituara më sipër, për secilin prej tyre duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (afati i vlefshmërisë së kontratave të punës duhet të jetë për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës)
- Listëpagesat e punonjësve (E-Sig 025) të deklaruara në organet tatimore, për periudhën Shkurt 2023 – Prill 2023.
- Diplomë ose / dhe çertifikata trajnimesh. Këto dokumenta duhet të jenë të lëshuara nga institucione të njohura ose akredituara në Republikën e Shqipërisë.

* OE mund të sigurojë shërbimin nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore **për automakinistët** me kontratë të vlefshme pune që mbulon të gjithë periudhën e ekzekutimit të shërbimit në kontratë.

Argumentimi : *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e*

meparshme për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, referuar tipologjise se kontrates.

Në përcaktimin e numrit te personelit kryesor specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si natyra e shërbimit objekt kontrate që kërkohet të kryhet, grafiku i shërbimit dhe kualifikimi i punonjësve (element shumë i rëndësishëm lidhur me njohuritë e tyre specifike për shërbimin që kërkohet të kryhet), gjithahshu orët e punës dhe pagën minimale te lejuar qe duhen për të përmbushur kontratën. Kualifikimi i tyre, grafiku i shërbimit tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë me sukses kontratën. Punësimi i një numri të caktuar te personelit kryesor , përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë.

- **1 (një) Ing. Pyjesh** është i domosdoshëm në zbatim të kërkesave ligjore për pajisjen me Licencat e kërkuara. Përvec pajisjes me Licencat përkatëse (në zbatim të kërkesave ligjore ne rolin edhe si Drejtues Teknikë), është e nevojshme që për ndjekien apo zbatimin e shërbimit, të jetë në dispozicion ky Ing. Pyjesh që ka të bëjë si me kuptimin e shërbimit që duhet të kryhet. Theksojmë se AK nuk mund të rrezikojë mbarëvajtjen e procesit të shërbimit për shkak të defekteve të mundshme të cilat lidhen me mirë-funksionimin e mjeteve. Për këtë qëllim specilisti i fushës gjykon se ky është një kriter i dosmodshëm për mbarëvajtjen e shërbimit.
- **1 (nje) inxhinier mjedisi/agromjedis/menaxhim mjedisi** i cili ka një ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e tokës duke u marre me çështje mjedisore lokale Ai përdor parimet e biologjisë dhe kimisë për të zhvilluar dhe zgjidhur problemet mjedisore. Ai eshte i perfshire në kontrollin e ndotjes së ujit dhe ajrit, riciklimin, depozitimin e mbeturinave dhe çështjet e shëndetit publik. Për këtë qëllim specilisti i tille i kerkuar nga grupi i specifikimeve dhe kriterëve teknike ka gjykuar se ky është një kriter i dosmodshëm për mbarëvajtjen e shërbimit.

- **1 (nje) Inxhinier Agronom** (për kujdesjen dhe mirëmbajtjen e bimësisë), domosdoshmëria i këtij profili punonjësi lidhet me natyrën e shërbimit e gjithashtu kohën e limituar në të cilën ky shërbim do të kryhet. AK kërkon siguri që shërbimi do të kryhet në standartin e duhur. Në këtë kuadër **inxhinieri Agronom**, i cili është specialist i fushës, duhet të ndjekë shërbimin nga afër për t'i dhënë zgjidhje çdo problemi të mundshëm për një shërbim sa më cilësor. Agronomët janë të nevojshëm pasi duhet të sigurojë përdorimin e preparateve të duhura, sipas specifikimeve teknike, për kryerjen e procesit të punës,
 - **3 (tre) shofere automakiniste** domosdoshmëria i këtyre shoferëve është e nevojshme për drejtimin e automjeteve të kërkuara (vinc, kamioncine, pick-up), Shoferi automakinist është i nevojshëm për drejtimin e autokullës me kosh dhe manovrimin e krahut të vincit gjatë procesit të punës në zbatim të kontratës së shërbimit të kërkuar.
 - **10 (dhjete) punetore** janë kërkuar si domosdoshmeri e kësaj kontrate punëtorët pasi janë të nevojshëm për aplikimin e lëndëve pesticide/insekticide, prerjen e degëve, përdorimin e pompave për dezinfektim etj.
-

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar një **1 (nje) Specialist për përgjegjësinë dhe shëndetin në punë** është në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", (i ndryshuar), i cili duhet të beje trajnimin teknik të punonjësve të tij mbi masat e sigurimit teknik përpara fillimit të procesit të punës. Operatori ekonomik duhet ta bëjë vetë trajnimin (dhe të paraqesë certifikatën përkatëse për kryerjen e trajnimeve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë) ose të ketë lidhur një kontratë të rregullt me një kompani për trajnime të tilla apo një punonjës të brendshëm si Koordinator Sigurie në Punë, vërtetuar kjo me paraqitjen e faturave dhe kontratës së lidhur me subjektin trajnues.

